



BASHKIA GJIROKASTËR
DREJTORIA E URBANISTIKËS

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI: REHABILITIMI I SEGMENTEVE TE
NDRYSHEM RRUGOR

PROJEKT ZBATIMI

Hartoi:

Ing. Antoneta Çako

Ing. Farold Mene

Ark. Enaida Xhuvani

QERSHOR 2024

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI: REHABILITIMI I SEGMENTEVE TË NDRYSHËM RRUGOR”.

- 1. TË PËRGJITHSHME**
- 2. CILËSIA DHE BURIMET E MATERIALEVE**
- 3. PUNIMET E SHITESAVE RRUGORE**

1.1 TE PERGJITHESHME

Keto Specifikime Teknike jane materiale shtese ne funksion te kushteve te pergjithshme dhe te vecanta te Kontrates.

1.2 Dokumentat

Kontraktori i Punimeve te Ndertimit do te verifikojte te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguar ne Vizatimet, Grafiket, ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Sipermarresin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme. Sipermarresi do te marre persiper te gjithe pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive, llojeve dhe sasive te materialeve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen. Rendi mbizoterues i dokumentave do te jete si me poshte: Oferta, Kushtet e Kontrates, Specifikimet e Vecanta, Specifikimet e Pergjithshme, Vizatime, Projekti, Preventivi.

1.3 Zevendesimet

Zevendesimi i materialeve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behet vetem me aprovimin e Mbikeqyresit te Punimeve nese materiali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materialet e specifikuara; ose nese materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates per shkak te kushteve jashte kontrollit te Sipermarresit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materialeve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

1.4 Furnizimi me uje.

Perpara se te dorezoje oferten, Kontraktori do te beje nje investigim nese ka uje te mjaftueshem per qellimin e Punimeve te tij dhe do te konsultohet dhe do te rregulloje me autoritetet perkatese, si dhe do te marre parasysh te gjitha aspektet ligjore. Kontraktori do te jete plotesisht pergjegjes per furnizimin e sasise se mjaftueshme te ujit te cilesise se specifikuar gjate gjithe kohes se Kontrates. Kostot e furnizimit me uje do te merren si te mbuluara ne çmimet dhe perqindjet e Kontrates.

1.5 Kushtet atmosferike dhe permbytjet.

Do te merret si e mireqene qe Kontraktori gjate pergatitjes se ofertes se tij do te kete marre parasysh te gjitha kushtet e mundshme atmosferike dhe rastet e permbytjeve ne kohen e perfundimit si dhe gjate Punimeve Permanente dhe te Perkohshme. Kontraktorit nuk i takon asnje pagese shtese si pasoje e ndodhjes, vazhdimesise apo efektit te ererave te forta, bores, acarit, shirave dhe permbytjeve, temperaturave apo lageshtires apo si pasoje e kushteve te tjera metereologjike apo hidrologjike.

1.6 Vizatimet e kontrates.

Vizatimet e Kontrates paraqiten ne Vellimin te ketyre Dokumentave te Tenderit. Ketu nuk do te aplikohet asnje vizatim qe lidhet me struktura standarte/tip apo me punime tipike ku nje pjese e se ciles apo e tera nuk kerkohet nga Preventivi (tabela e volumeve) apo qe eshte pjese e Kushteve te Pergjithshme.

1.7 Piketimi

Piketimi do te behet ne perputhje me Vizatimet e projektit apo sipas instruksioneve te Supervizorit. Megjithate, Kontraktori do te pergjigjet per kryerjen e studimit fillestar mbi gjurmen egzistuese dhe do te pergatise vizatimet e projektit te detajuar te ndertimit, dhe te detajeve te propozuara te ndertimit per aprovim te Supervizor.

1.8 Programi i Punimeve

Punimet do te zbatohen ne menyre te tille qe te sigurojne perfundimin e njepasnjeshem dhe te plote te zerave te punes. Radha e zbatimit te Punimeve do te varet nga ndryshimet e mundshme, te justifikuara, qe do te behen nga Supervizori.

1.9 Kantieri, ofiçinat, magazinat, zyrat etj. e Kontraktorit.

Kontraktori do te ndertoje, ruaje dhe mirembaje nje kantier per punetoret e tij se bashku me ofiçinat, magazinat, zyrat, kushte higjenike dhe paisjet e ndihmes se shpejte. Kantieri i ndertimit dhe ndertesat e tjera do te aprovohen nga Supervizori. Akomodimi, mensa do te jene ne perputhje me shkallen e Kontrates. Kantieri dhe ndertesat e tjera do te mbahen ne kushte te mira higjenike. Me perfundimin e Kontrates, e gjitha ndertesat e siguruara nga kontraktori do te hiqen po nga Kontraktori pa asnje kosto shtese per Punedhenesin dhe Kantieri do te lihet i paster dhe ne rregull. Çdo pjese e kampit apo ndertesave qe kerkohet nga Punedhenesi do t'i jepet Punedhenesit me nje kosto qe do te negociohet nga palet.

1.10 Tualetet.

Gjate gjithe periudhes se ndertimit, Kontraktori do t'u siguroje punetoreve te tij tualete te mjaftueshme te cilat do t'i mirembaje dhe pastroje. Kontraktori do te sigurohet qe punetoret te mbajne paster kantierin dhe t'i perdorin mire tualetet.

1.11 Cilesia e Materialeve dhe Krahut te Punes.

Te gjitha materialet e perfshira ne Punimet e Perhershme do te jene ne perputhje me kluzolat perkatese te ketyre Specifikimeve. Po keshtu edhe krahu i punes duhet te jete ne perputhje me Specifikimet dhe te gjithe duhet te kene aprovimin e Supervizorit.

1.12 Aprovimi i Furnizuesve te Materialeve dhe Mallrave.

Perpara se Kontraktori te hyje ne nje nen-kontrate per furnizimin e materialeve apo mallrave, ai duhet te kete per kete qellim aprovimin me shkrim te Supervizorit per Furnizuesin nga i cili Kontraktori propozon te marre mallrat apo materialet. Ne rast se Supervizori ne çfaredo momenti eshte i pakenaqur me keto mallra apo materiale apo me metodat apo operacionet qe kryhen ne punimet apo vendin ku zhvillon biznesin Furnizuesi, Supervizori ka fuqine te anulloje aprovimin me shkrim qe ka bere vete me pare per kete Furnizues dhe ka te drejten te propozoje furnitore te tjere per furnizimin e atyre mallrave apo materialeve. Kontraktori atehere do t'i marre ato mallra apo materiale nga ata furnitore dhe eshte vete pergjegjes per pagesen e kostove shtese te tyre.

1.13 Tabelat Lajmeruese.

Kontraktori do te siguroje dhe vendose nje Tabele ne dy hyrjet kryesore te Kantierit dhe ne zyrat e Kantierit, kur kjo kerkohet nga Supervizori. Kjo tabele, me brendashkrimet e duhura, do te perfshije titullin e e Projektit, emrin e Punedhensesit, emrin e Institucionit Financues, emrin e Supervizorit dhe emrin e Kontraktorit. Tabela me permasa 2.00x2.50 metra duhet te miratohet me pare nga Supervizori dhe pastaj te varet.

2.CILESIA DHE BURIMET E MATERIALEVE

2.1 Karakteristikat e Materialeve.

Materialet qe do te perdoren gjate punimeve duhet t'i permabahen standarteve dhe rregullave nderkombetare per materialet e punimeve civile. Ne rast se nuk ka kerkesa specifike materialet duhet te jene te cilesise me te mire qe ekziston ne treg dhe qe perdoren per qellimet e caktuar. Megjithate, materialet duhet te aprovohen nga Supervizori perpara se te vihen ne perdorim.

2.2 Burimet e Materialeve.

Materialet do te sigurohen nga ato burime ose fabrika qe konsiderohen te pershtatshme nga Kontraktori, duke u siguruar se zbatohen rregullat e mesiperme. Ne rast se Supervizori refuzon materialet si te papershtatshme per perdorim, atehere, Kontraktori duhet t'i zevendesojte ato me materiale te tjera qe i korespondojne karakteristikave te deshiruara, materialet e refuzuara duhet te hiqen nga vendi i ndertimit nen kujdesin dhe me shpenzimet e Kontraktorit. Megjithe aprovimin e materialeve nga Supervizori, Kontraktori mbetet pergjegjes i plote i punes se specialisteve si edhe te vete materialeve.

3.PROJEKT ZBATIMI

Punimet e shtresave rrugore për objektin “Rehabilitim i segmenteve të ndryshme rrugore” do të realizohen në këto fshatra:

- “Hundëkuq”, Njësia adminstative Odrie,
- “Prongji”, Njësia administrative Cepo,

- “Gjat”, Njësi administrative Lunxheri,
- “Shtepez”, Njësia Administrative Picar,
- Rruga lidhëse midis fshatrave Nokov-Mingul, njësi administrative Lunxhëri,
- “Plesat”, Njësi administrative Cepo,
- “Valare”, Njësi administrative Antigone,
- “Kodër”, Njësia administrative Cepo.
- “Asim Zeneli “ njësi administrative Antigone

Punimet që parashikohen të kryhen konsistojnë në:

- Gërmim dhe shkëmbi për kanale; Gërmim seksion i lire+transport me auto (analizë).-

Ky çmim përfshin teresinë e punimeve dhe puntorinë që lidhet me gërmimin e dheut në toke të forta e mesatare me makineri apo me krahe, për profilimin e rrugës. Ky çmim përfshin gjithashtu koston e ngarkimit, transportit, shkarkimit, hedhjen në vendet e autorizuara për depozitimin e materialeve të tepërta të evaduar. Ky çmim i referohet 1 m³ gërmim.

- Prishje shtrese t=10 cm me makineri

Skarifikimi me makineri i shtesës të çakellit ekzistues në rrugë është parashikur të kryhet me makineri netrashësine 10cm duke e ngarkuar në mjete dhe hidhet në vendet e përcaktuara me parë ngainvestori. Matja do të bëhet në 1m².

- Shtrese zhavorri 10 cm në rrugë (nr analizë 3.183/a)-

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve dhe punëtorisë që lidhen me blerjen ose prodhimin e zhavorrit, ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen, hapjen në vepër dhe rulimin në lagështirë, sipas kushteve teknike, sipas profilit të paraqitur në projekt, me trashësi minimale 10 cm poshtë shtresës së betonit me zgarë hekuri, siç përcaktohet në preventiv. Ky çmim i referohet 1 m³.

- Shtrese betoni në rrugë t=12cm.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve dhe punëtorisë që lidhet me blerjen e betonit ose të materialeve për prodhimin e betonit C 16/20 (i cili duhet të jetë me granil të larë, rërë të larë dhe çimento), përgatitjen e armaturës së dërrasës, hedhjen në vepër të betonit, në rastin e shtresave në rrugë, në bordurë, me trashësinë e dhënë në projekt, ngarkimin transportin, shkarkimin e materialeve të nevojshme (rërë e lare, granil I lare çimento, dërrase, gozhde dhe çdo gjë tjetër të nevojshme) Ky çmim i referohet 1 m³ Te

lihen fugat e temperaturës në distancë 20-25 m larg njëra-tjetrës. Gjithashtu të merren masa për trajtimin e shtreseës së betonit me ujë.

- *F.V.plegmë (rrjetë hekuri) (analizë).*

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve dhe punëtorise që lidhet me vendosjen e zgares së hekurit me $d=4\text{mm}$ me kuadrate (15x15 cm)kostojo e blerjes se saj dhe cdo gje tjeter qe eshte e nevojshme, ngarkimin transportin,shkarkimin e materialeve te nevojshme ky çmim I referohet 1 m².

- *Mbushje e sheshit me çakëll natyror.*

Ne hapin perfundimtar konsistojme me mbushje shtrese cakelli mbeturine kave $t=20$ per bankinat. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve dhe punëtorisë që lidhen me mbushjen me çakëll natyror për profilimin e trupit të rruges në thellesinë e dhene ne profilet terthore te projektit , ne lageshtire te ketij materiali . Gjithashtu ketu duhet te futet edhe kostoja e blerjes , prodhimit , ngarkimit, transportit, shkarkimit, te materialeve te nevojshme. Ky çmim i referohet 1m³.